

Çfarë ndodh nëse nuk marr një vendim përfundimtar për arsyet nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar?

- Në varësi të rrethanave, mund të referoheni tek agjencia përkatëse e zbatimit të ligjit - forca policore përkatëse ose Ministria e Brendshme.
- Nëse nuk jeni një shtetas britanik ose i BE-së dhe nuk ka rrethana të tjera që mund t'ju japin të drejtën të jetoni në Mbretërinë e Bashkuar, do t'ju ofrohet mbështetje për t'u kthyer në mënyrë vullnetare në vendin tuaj të origjinës.

Çfarë ndodh nëse e refuzoj mbështetjen tani, por vendos më vonë se kam nevojë për mbështetje ose për më shumë informacione?



Mund të referoheni vetë te **Beacon** në numrin 03000 11 55 55 (opsioni 3). Faqja e tyre e internetit (www.hertfordshirebeacon.org) siguron informacione të dobishme për trajtimin e efekteve të shfrytëzimit dhe për njohjen e procesit të drejtësisë penale. Ajo ka po ashtu detaje për agjenci të tjera lokale në Hertfordshire që mund t'ju ofrojnë mbështetje emocionale dhe praktike.



Mund të referoheni vetë në **Linjën telefonike kombëtare të ndihmës për skllavërinë moderne** e disponueshme në 24 orë në numrin 08000 121 700, e cila mund t'ju ofrojë këshilla të menjëhershme në mbi 200 gjuhë. Kjo linjë telefonike e ndihmës drejtohet nga një organizatë bamirëse, Unseen, dhe është e pavarur, profesionale dhe e besuar. Ashtu si me Beacon, mund të merrni mbështetje nga linja telefonike e ndihmës pa qenë e nevojshme të keni lidhje me policinë ose me qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar.



The Salvation Army ofron një program mbështetës profesional për mbrojtjen dhe kujdesin për të gjitha viktimat e moshës madhore.

Linja e tyre e besuar telefonike e ndihmës për referimin në 0300 3038151 është e disponueshme 24 orë në ditë, shtatë ditët e javës. Për të pasur akses te mbështetja prej tyre, duhet të pranoni të hyni në Mekanizmin Kombëtar të Referimit në pikën e referimit.

Për më shumë informacione për shfrytëzimin dhe burime të tjera, këshillohuni me faqen e internetit të Hertfordshire Modern Slavery Partnership: www.stopexploitationherts.org.uk/victims-and-families/victims-and-families.aspx.

INSTRUCTION TO PROFESSIONALS & NGOs: Please ensure that the individual presenting can read and has the mental capacity to give informed consent to the National Referral Mechanism (NRM). Refer to the victim referral pathways for further information. This flyer should only be taken home by the individual presenting if they are residing in a safe location. If not, you are potentially putting them at risk.



Mbështetja e disponueshme për të rriturit që shfrytëzohen në Mbretërinë e Bashkuar: Broshura e mbështetjes e Mekanizmit Kombëtar të Referimit

A mund të më ndihmojë dikush?

Nëse zbulohet se jeni shfrytëzuar në Mbretërinë e Bashkuar, ju keni të drejtën për të marrë ndihmë të pavarur, emocionale, mjekësore dhe praktike nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Kjo mbështetje mund të ofrohet në disa mënyra të ndryshme, duke përfshirë:



- ✓ gjetjen e strehimit të sigurt të përkohshëm për ju.
- ✓ ndihmën me trajtime mjekësore për ju.
- ✓ ndihmën e një personi për të përballuar eksperiencën që po kaloni.
- ✓ ofrimin e një përkthyesi/interpreti për t'ju ndihmuar të komunikoni në anglisht.
- ✓ mbrojtjen e policisë, nëse raportoni tek ata situatën e shfrytëzimit tuaj.
- ✓ këshillim ligjor të pavarur.
- ✓ pagesa asistence.

Sistemi zyrtar i mbështetjes i qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar: Mekanizmi Kombëtar i Referimit



Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka krijuar një sistem të quajtur **Mekanizmi Kombëtar i Referimit**, i cili mundëson ofrimin e mbështetjes nga shteti.

Duke pranuar që të referoheni nëpërmjet këtij sistemi, çështja juaj do të hetohet dhe nëse arrihet në përfundimin se po shfrytëzoheni, do t'ju ofrohet ndihmë dhe mbrojtje nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

1. A duhet ta përfshij qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar apo policinë nëse dëshiroj të dal nga situata ime aktuale e shfrytëzimit?

Jo. Nëse nuk dëshironi ta përfshini qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar ose policinë, atëherë Hertfordshire ka një shërbim lokal mbështetës të quajtur Beacon, i cili është i ndarë nga qeveria dhe policia. Ju mund të merrni mbështetje nga Beacon dhe nuk është e nevojshme të bashkëpunoni me policinë ose me qeverinë. Detajet tuaja do të mbahen po ashtu konfidenciale.



Çfarë mbështetje do të marr nga Beacon?

Do t'ju caktohet një menaxher i çështjes i trajnuar në mënyrë të posaçme që:

- Do t'ju mbështesë gjatë rikuperimit tuaj nëpërmjet një plani të individualizuar të mbështetjes.
- Do të veprojë si avokati juaj.
- Do t'ju referojë te partnerët me aftësi dhe njohuri të specializuara që mund t'ju mbështesin më mirë (nëse e pranoni këtë).



Mbështetja mund të përfshijë:

- Mbështetje emocionale dhe praktike.
- Mbrojtje.
- Akses te drejtësia rikuperuese dhe rritja e sigurisë (Beacon do t'ju shpjegojë më tej për këtë lloj mbështetjeje).
- Mbështetje për garantimin e sigurisë suaj personale.

Nëse nuk e pranoni mbështetjen nga Beacon, kini parasysh se shërbimi është gjithmonë i hapur për ju dhe mund të referoheni vetë nëpërmjet faqes së internetit (www.hertfordshirebeacon.org).

2. Çfarë ndodh nëse vendos të flas me policinë?

- Hertfordshire ka një njësi policore profesionale që punon vetëm për ndalimin e shfrytëzimit të njerëzve në zonë.
- Ata kanë eksperiencë të konsiderueshme në punën me individë si ju.
- Ata do të flasin me ju për atë që ka ndodhur.
- Juve do t'ju ofrohet mbrojtje nga çdo person që mund t'ju lëndojë.
- Ata do të nisin një hetim.
- Ju do të informoheni vazhdimisht për progresin e hetimit.

3. Çfarë ndodh nëse vendos që të përfshij qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar të Referimit?

Qeveria do të vendosë brenda 5 ditësh pune nga marrja e referimit nëse ka arsye të besueshme se jeni shfrytëzuar, ose jashtë shtetit, ose në Mbretërinë e Bashkuar.

Gjatë periudhës 45-ditore, ju do të mund të përcaktoni hapat tuaj vijues, ndërkohë që prisni për konfirmimin përfundimtar se ju janë pranuar arsyet përfundimtare pozitive që jeni shfrytëzuar. Pas marrjes së një vendimi përfundimtar pozitiv për arsyet, do t'ju jepen 45 ditë të tjera, duke arritur në total 90 ditë për periudhën e reflektimit dhe rikuperimit.

Nëse referimi ka sukses:

do t'ju caktohet një vend në një strehim të sigurt të financuar nga qeveria, nëse kërkohet.

do t'ju jepet një periudhë reflektimi dhe rikuperimi prej të paktën 45 ditësh kalendarike.

Nëse kjo konfirmohet, atëherë mund të keni të drejtën për:

- Leje opsionale për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar për një vit nëse bashkëpunoni plotësisht në çdo hetim policor dhe ndjekje penale vijuese. Kjo periudhë e lejes opsionale mund të zgjatet nëse kërkohet.
- Dhënie e një lejeje opsionale për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar, e cila do të jetë në varësi të rrethanave tuaja personale.
- Ndhimë dhe asistencë financiare për t'u kthyer në shtëpi nëse nuk dëshironi të qëndroni në Mbretërinë e Bashkuar.
- Mbështetje nga ambasada juaj lokale dhe çdo organizatë përkatëse joqeveritare.